



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES

Nr. 1024/prot.
11

Tiranë, më 05.12 2025

VENDIM
Nr. 66, datë 05.12 2025

PËR
PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË
VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. nr. 23, datë 13.03.2024

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, dhe Rregulloren, "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, (e ndryshuar), pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit të Zbatimit të Vendimeve Paralajmëruese dhe Koordinimit, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit nr. 23, datë 13.03.2024, të Komisionerit, "Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin e Bashkisë Prrenjas dhe paralajmërimin e institucionit për rregullimin e ligjshmërisë, me qëllim përmirësimin e situatës",

KONSTATOVA SE:

Me urdhrin nr. 103, datë 07.12.2023, "Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil nëpërmjet pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, në Bashkinë Prrenjas", Komisioneri ka filluar mbikëqyrjen në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil, duke vlerësuar respektimin e kërkesave të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, nga ana e subjekteve të ngarkuara prej ligjit me detyra specifike për administrimin e këtij procesi në institucionin Bashkia Prrenjas.

Ky proces është përmbyllur me Vendimin nr. 23, datë 13.03.2024, të Komisionerit, Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil nëpërmjet pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, në Bashkinë Prrenjas", ku janë lënë detyra konkrete për rregullimin e ligjshmërisë.

Me kalimin e afatit të lënë në vendimin e mësipërm, me Urdhrin nr. 53, datë 24.06.2025, *“Për kryerjen e mbikëqyrjes në vazhdim në lidhje me zbatimin e vendimit paralajmërues nr. 23, datë 13.03.2024, të Komisionerit”*, Komisioneri ka urdhëruar fillimin e mbikëqyrjes në vazhdim për zbatimin e vendimit paralajmërues nr. nr. 23, datë 13.03.2024, në institucionin Bashkia Prrenjas, sipas drejtimeve të programit të mbikëqyrjes në vazhdim nr. 634/1, datë 24.06.2025, të miratuar nga Komisioneri, njoftuar Kryetarit të Bashkisë Prrenjas me shkresën nr. 634/2, datë 24.06.2025, *“Njoftim për fillimin e procesit të mbikëqyrjes së zbatimit të vendimit nr. 23, datë 13.03.2024 të Komisionerit”*. Në zbatim të këtyre akteve, grupi i punës është paraqitur pranë institucionit të mbikëqyrur dhe, në përfundim të procesit, ka hartuar aktin e konstatimit, në të cilin është pasqyruar niveli i rregullimit të ligjshmërisë dhe është administruar dokumentacioni që provon zbatimin e pjesshëm të vendimit objekt verifikimi.

Mbikëqyrja në subjekt u krye në datat 13-24 janar 2025. Në përfundim të procesit, grupi i punës mbajti një procesverbal, ku u evidentua situata në lidhje me ecurinë e masave të marra nga institucioni.

Në vijim, duke pasur parasysh një sërë problematikash objektive dhe subjektive që hasen gjatë administrimit të shërbimit civil, sidomos në rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin dhe zbatimit të institutit të rekrutimit në shërbimin civil, me qëllim shterimin e të gjitha masave për arritjen e zbatimit të vendimit paralajmërues, si dhe për të dëgjuar arsyet e mosveprimit në kohë nga ana e institucionit, Komisioneri me anë të urdhrit nr. 51, datë 18.06.2025, *“Për zhvillimin e seancave dëgjimore në kuadër të masave për zbatimin e vendimeve paralajmëruese”*, urdhëroi që, procesi të vijojë me zhvillimin e një seance dëgjimore me Kryetarin e Bashkisë ose përfaqësues të caktuar prej tij dhe drejtuesit e njësive përgjegjëse (*njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore*) të institucionit.

Seanca u zhvillua në datën 26.06.2025, në ambientet e Komisionerit, me pjesëmarrjen e Drejtorit të Burimeve Njerëzore të institucionit. Gjatë seancës u konstatua se për pikat 4, 5 dhe 6 situata nuk ka ndryshuar nga verifikimi i fundit i bërë në subjekt në janar 2025, ndërsa për pikën 7 janë marrë disa masa (*sikundër do të evidentohet më hollësisht në vijim gjatë analizës së kësaj pike të vendimit*). Në përfundim të seancës, duke marrë parasysh edhe situatën e ndikuar nga zgjedhjet e përgjithshme për Kuvendin e Shqipërisë, gjatë së cilës u pezullua procesi i rekrutimit, u vlerësua e nevojshme që institucionit t’i lihet edhe një afat tjetër për përmbushjen e detyrimeve, deri më datë 15.09.2025.

Më tej, me qëllim lehtësimin e procesit dhe sigurimin e një zbatimi sa më efektiv të detyrave të përcaktuara, është mbajtur komunikim i vazhdueshëm me njësinë përgjegjëse të subjektit, si nëpërmjet korrespondencës elektronike, ashtu edhe përmes komunikimeve telefonike, duke ofruar asistencën e nevojshme për sqarimin e paqartësive të hasura gjatë procesit të zbatimit të plotë të vendimit të Komisionerit.

Mbështetur në detyrat e lëna në Vendimin nr. 23, datë 13.03.2024, si dhe referuar informacionit të administruar në subjekt, përfshirë komunikimin shkresor dhe atë

elektronik (me e-mail), situata e administrimit të shërbimit civil në institucionin e mbikëqyrur paraqitet si më poshtë vijon:

Në **pikën 2** të vendimit paralajmërues, Komisioneri ka kërkuar nga njësia përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara me detyra në administrimin e shërbimit civil që të hartojnë dhe miratojnë planin vjetor të rekrutimit brenda muajit mars të vitit 2024, si dhe për vitet pasuese, brenda afateve të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi. Pas miratimit, plani duhet të publikohet pranë Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, në përputhje me kërkesat procedurale të parashikuara në ligj.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar pranë subjektit, si edhe nga komunikimet zyrtare të përcjella në rrugë shkresore, rezulton se Bashkia Prrenjas ka miratuar planin vjetor të pranimeve në shërbimin civil me vendimin nr. 48, datë 27.03.2024, *“Për planin vjetor të pranimet në shërbimin civil të Bashkisë Prrenjas për vitin 2024”*. Ky vendim është përcjellë pranë Komisionerit të Shërbimit Civil me shkresën nr. 1048/1 prot., datë 30.04.2024.

Në **pikën 3**, Komisioneri i ka kërkuar njësisë përgjegjëse të institucionit që të ngrejë Komitetin e Përherëshëm të Pranimet (KPP), organ i cili duhet të funksionojë për të gjitha procedurat e pranimet në kategorinë ekzekutive gjatë gjithë vitit, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion grupit të punës në institucionin e Bashkisë Prrenjas rezulton se detyrimi që buron nga kjo pikë është përmbushur. Konkretisht, me Urdhrin nr. 678, datë 30.12.2022, *“Për ngritjen e Komitetit të Përherëshëm të Pranimet”*, subjekti ka ngritur strukturën përgjegjëse për zhvillimin e procedurave të pranimet në shërbimin civil, në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse.

Në **pikat 4 dhe 5**, Komisioneri ka kërkuar nga eprori direkt, që:

- i. Të caktojë nëpunësit mbikëqyrës për punonjësit në periudhë prove dhe, në përfundim të kësaj periudhe, të kryejë vlerësimin e rezultateve të punës, duke i vlerësuar me notë të gjitha rubrikat e formularit të vlerësimit dhe duke plotësuar komentet dhe shpjegimet përkatëse.
- ii. Bazuar në rezultatet e testimit pas trajnimit të detyrueshëm në ASPA, në vlerësimin e rezultateve individuale të punës dhe në mendimin me shkrim të nëpunësit më të vjetër, nën kujdesin e të cilit është vendosur punonjësi në periudhë prove, të marrë një vendim të arsyetuar për:
 - o konfirmimin e nëpunësit në detyrë, ose
 - o zgjatjen një herë të vetme deri në 6 muaj të periudhës së provës, ose
 - o moskonfirmimin, sipas rastit;duke njoftuar si punonjësin, ashtu edhe njësinë përgjegjëse.

Rezulton se, me anë të shkresës nr. 732/1 prot., datë 30.09.2025, Bashkia Prrenjas ka përcjellë vendimin nr. 1530 prot., datë 11.07.2025, *“Mbi caktimin e nëpunësit më të vjetër*

civil për mbikëqyrjen e nëpunësve civilë në periudhë prove". Bashkëngjitur kësaj shkrese është paraqitur edhe mendimi i nëpunësit civil më të vjetër për nëpunësit që kanë përfunduar periudhën e provës, konkretisht për:

- Anjeza Bozha, në pozicionin "*Specialist i Auditit të Brendshëm*";
- Rezarta Dashi, në pozicionin "*Specialist Prokurimesh*", Drejtoria Juridike dhe e Burimeve Njerëzore;
- Ledjo Allkoja, në pozicionin "*Specialist i IT-së*", Drejtoria Juridike dhe e Burimeve Njerëzore.

Vlerësojmë se Bashkia Prrenjas i ka realizuar pjesërisht detyrimet që lidhen me procesin e mbikëqyrjes dhe vlerësimit të nëpunësve në periudhë prove. Ndonëse janë ndërmarrë hapat fillestarë, si caktimi i nëpunësit më të vjetër dhe administrimi i mendimit të tij për secilin nëpunës, ende mbetet për t'u finalizuar nga eprori direkt vlerësimi i plotë sipas formularit përkatës dhe marrja e vendimit të arsyetuar përfundimtar.

Në pikën 6, Komisioneri ka kërkuar që të vijojnë procedurat e konkurrimit për të gjitha vendet vakante të shërbimit civil, në kuptim të legjislacionit në fuqi, duke përfshirë:

1. Pozicionet efektivisht të lira;
2. Pozicionet që janë plotësuar në kundërshtim me ligjin.

Procedurat duhet të zhvillohen në përputhje me strukturën aktuale të institucionit në momentin e ekzekutimit të vendimit të Komisionerit, duke miratuar një planifikim të qartë të procesit, që përcakton për secilin pozicion: përshkrimin e detyrës dhe afatin konkret për realizimin e konkurrimit.

Referuar dokumentacionit të dërguar nga Bashkia Prrenjas, rezulton se me shkresën nr.1529 prot., datë 11.07.2025, e titulluar "*Plan veprimi për Publikimin e Pozicioneve të Lira për vitin 2025*", miratuar nga Kryetari i Bashkisë, janë parashikuar procedurat e konkurrimit për 41 pozicione të lira, të ndara sipas kategorive:

- 1 pozicion i nivelit të lartë drejtues (*Sekretar i Përgjithshëm*).
- 3 pozicione të kategorisë së nivelit të mesëm drejtues (*Drejtor drejtorie*).
- 7 pozicione të kategorisë së nivelit të ulët drejtues (*Përgjegjës sektori*).
- 30 pozicione të kategorisë së nivelit ekzekutiv (*Specialistë*).

Ky plan veprimi parashikon publikimin e pozicioneve të lira për vitin 2025 deri në muajin dhjetor të këtij viti.

Referuar dokumentacionit të administruar gjatë seancës dëgjimore, si dhe të gjithë korrespondencës së dërguar nga njësia përgjegjëse me emailin e datës 07.10.2025, rezulton se institucionit ka përcjellë pranë Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive një sërë shpalljesh për pozicione vakante në shërbimin civil, siç do të evidentohet në vijim. Nga analiza e këtij dokumentacioni, konstatohet se për disa pozicione procedurat janë rishpallur në mënyrë të njëpasnjëshme, duke rezultuar pa fitues për shkak të mungesës së kandidaturave.

Konkretisht, janë shpallur në mënyrë të përsëritur pozicionet “*Specialist (prokurimesh)*” dhe “*Specialist (për turizmin)*” me aktet: Shkresa nr. 1115 prot., datë 28.05.2025; Kërkesë për publikim nr. 1313 prot., datë 28.05.2025; Kërkesë për publikim nr. 1242 prot., datë 11.06.2025; Kërkesë për publikim nr. 1349 prot., datë 23.06.2025; si dhe pozicioni “*Sekretar i Përgjithshëm*”, me aktet: Kërkesë për publikim nr. 387 prot., datë 11.02.2025; Kërkesë për publikim nr. 504 prot., datë 27.02.2025; Kërkesë për publikim nr. 1313 prot., datë 18.06.2025; Shkresa nr. 2014 prot., datë 08.09.2025.

Njëkohësisht, rezulton se njësia përgjegjëse ka shpallur procedurat për plotësimin e pozicioneve vakante si vijon:

- Kërkesë për publikim nr. 1292 prot., datë 16.06.2025, drejtuar AKPA, bashkëngjitur së cilës ndodhen shpalljet për pozicionet:
 - *Drejtor në Drejtorinë e Integritit European, Projekteve dhe Performancës.*
 - *Përgjegjës Sektori në Sektorin e Taksave dhe Kontabilitetit, Drejtoria e Planifikimit, Menaxhimit Financiar dhe Shërbimeve Sociale.*
 - *Përgjegjës Sektori në Sektorin e Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë dhe Turizmit.*
 - *Specialist (kadastrë), në Sektorin e Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë dhe Turizmit.*
- Kërkesë për publikim nr. 1313 prot., datë 18.06.2025, drejtuar AKPA, bashkëngjitur së cilës ndodhen shpalljet për pozicionin:
 - *Përgjegjës Sektori në Sektorin e Planifikimit, Hartimit dhe Implementimit të Projekteve, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit të Territorit dhe e Pronës.*
- Kërkesë për publikim nr. 1350 prot., datë 23.06.2025, drejtuar AKPA, bashkëngjitur së cilës ndodhen shpalljet për pozicionet:
 - *Përgjegjës në Sektorin e Bujqësisë dhe Administrimit të Tokave Bujqësore, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë dhe Turizmit.*
 - *2 Specialistë të Ndihmës Ekonomike dhe PAK, Njësia Administrative Rrajcë.*
 - *Specialist Protokolli, Sektori i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Arkivit, Protokollit dhe Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse.*
- Shkresa nr. 2267 prot., datë 01.10.2025, drejtuar AKPA, për pozicionin e mëposhtëm:

- *Përgjegjës në Sektorin e Planifikimit të Territorit / Administrimit të Lejeve Legalizimeve dhe Regjistrimit të Pronave.*

Në pikën 7 të vendimit paralajmërues, Komisioneri ka kërkuar nga Kryetari i Bashkisë Prrenjas të konstatojë pavlefshmërinë absolute të akteve të emërimit për 37 punonjës të emëruar në kundërshtim me ligjin, në pozicione pune që rregullohen nga ligji nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar rezulton se Kryetari i Bashkisë ka ndërmarrë veprime konkrete vetëm për 10 prej këtyre rasteve, përmes akteve të ndërprerjes së marrëdhënies së punës dhe financiare ose lëvizjes në detyrë jashtë shërbimit civil, si më poshtë:

- Urdhri nr. 330, datë 10.07.2024, "Për ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe financiare për z. Gazment Çuku", me detyrë Kryeinspektor në Inspektoriatin Vendor të Mbrojtjes së Territorit dhe Mjedisit;
- Urdhri nr. 489, datë 29.10.2024, "Lëvizje në detyrë dhe Komandim Kompetencash të znj. Blerina Blloshmi", nga pozicioni Specialiste Arkiv/Protokoll në detyrën Specialiste Arkivi në Sektorin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Arkivit, Protokollit dhe Shërbimeve Mbështetëse;
- Urdhri nr. 321, datë 02.07.2024, "Për ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe financiare për znj. Luiza Hallidri";
- Urdhri nr. 478, datë 29.10.2024, "Lëvizje në detyrë të znj. Marseda Vasku", nga pozicioni Drejtor në Drejtorinë e të Ardhurave, Taksave dhe Tarifave Vendore, në pozicionin Specialiste Licensimit/Transportit në Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore, Agjencia e Funksioneve, Bashkia Prrenjas;
- Urdhri nr. 190, datë 02.04.2024, "Për ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe financiare për z. Rexhep Beqo".
- Urdhri nr. 504, datë 31.10.2024, me anë të të cilit znj. Erjola Stojna, ka kaluar në pozicionin "Specialist (mbrojtje konsumatori)", në Agjencinë e Funksioneve, pozicion pune jashtë shërbimit civil;
- Urdhri nr. 548, datë 18.11.2024, me anë të të cilit znj. Ornela Mara, ka kaluar në pozicionin "Specialist regjistrim/vlerësim...", në Agjencinë e Funksioneve, pozicion pune jashtë shërbimit civil;
- Urdhri nr. 478, datë 29.10.2024, me anë të të cilit znj. Marseda Vasku, ka kaluar në pozicionin "Drejtor", në Drejtorinë e të Ardhurave, në Agjencinë e Funksioneve, pozicion pune jashtë shërbimit civil;
- Urdhri nr. 549, datë 18.11.2024, me anë të të cilit z. Aurel Ozuni, ka kaluar në pozicionin "Inspektor", në Drejtorinë e të Ardhurave, në Agjencinë e Funksioneve, pozicion pune jashtë shërbimit civil;
- Urdhri nr. 556, datë 18.11.2024, me anë të të cilit z. Oltion Leka, ka kaluar në pozicionin "Inspektor", në Drejtorinë e Pyjeve dhe Kullotave, në Agjencinë e Funksioneve, pozicion pune jashtë shërbimit civil;

Në përfundim, në bazë të të gjitha gjetjeve të paraqitura më sipër, vlerësoj se Bashkia Prrenjas ka filluar të zbatojë detyrat e lëna në Vendimin Paralajmërues nr. 23, datë 13.03.2024 të Komisionerit, nëpërmjet veprimeve konkrete administrative, për të gjitha detyrat e lëna, por ende nuk e ka përfunduar atë.

Sa i takon aspektit më problematik që ka të bëjë me rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin, në kushtet kur ky proces ka një nivel kompleks vështirësie që kërkon njohuri të thelluara në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore si edhe kapacitete të mjaftueshme në përbërje dhe mbështetje të njësisë përgjegjëse për administrimin e burimeve njerëzore të institucionit, të cilat janë të kufizuara në njësitë e administratës vendore, e sidomos në këto bashki me një numër relativisht të ulët banorësh, e po kështu, duke njohur faktin se ky proces kërkon një periudhë kohore relativisht të gjatë për t'u implementuar, si për shkak të afateve procedurale, ashtu edhe për arsye të ndryshme objektive, që kryesisht qëndrojnë në mungesën e kandidatëve të interesuar për të marrë pjesë në procesin e rekrutimit, vlerësojmë se për realizimin e detyrave, institucionit duhet t'i mundësohet një afat kohor që shkon përtej atij të vendosur nga Komisioneri në vendimin e paralajmërimit.

Me synim plotësimin e detyrave të lëna në vendim, në koherencë edhe me zhvillimet aktuale, që përkojnë me hartimin e strukturave të reja organizative të njësisë të administratës vendore për vitin 2026, si edhe me qëllim që këto institucione të mbështeten me asistencë teknike si nëpërmjet trajnimeve nga ASPA, ashtu edhe nga stafi i Komisionerit, për të zbatuar drejt kërkesat e ligjit dhe procedurat ligjore rast pas rasti, vlerësojmë se ndjekja e procesit të rivendosjes së ligjshmërisë, përgjatë vitit 2026, duhet të vijojë përmes mbikëqyrjes online dhe mbikëqyrjes së orientuar për implementimin e skemës së administrimit të shërbimit civil në përbërje të strukturës organizative në njësitë e vetqeverisjes vendore, të cilat janë procese që aktualisht realizohen nga stafi i Komisionerit, përgjatë gjithë vitit kalendarik.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *"Për nëpunësin civil"*, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 *"Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"* dhe Rregulloren, *"Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit"*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, (e ndryshuar).

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit nr. 23, datë 13.03.2024, të Komisionerit, *"Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil nëpërmjet pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, në Bashkinë Prrenjas"*.

2. Ndjekjen e detyrave të pazbatuara, të evidentuara në pjesën arsyetuese të këtij vendimi, përmes mbikëqyrjes online dhe, në varësi të ecurisë, nëse shkeljet nuk adresohen plotësisht, institucioni të jetë objekt i procedurës së mbikëqyrjes së përgjithshme apo tematike gjatë vitit 2026.
3. Për këtë vendim të njoftohet Bashkia Prrenjas.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

